



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Himarë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCES VERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shpenzime për blerje detergjentësh”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39831200-8**  
Detergjent

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2,496,000** (dy milion e katerqinde e nentedhete e gjashte mije)  
**lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Vore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 e 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".*

*Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën*

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c", të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" , ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: *“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi, çka rrit besueshmërinë te Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës.*

---

**2.3.2** Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- a) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklarate që merr persiper, me mjetet e veta, transportin e mallrave objekt prokurimi, në ambjentet e përcaktuara në DT, nga nënshkrimi i kontratës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor, për këtë procedurë prokurimi mjaftohet me një deklaratë nga operatori ekonomik për të konfirmuar marrjen persiper të transportit të mallrave objekt prokurimi në kohe dhe sasi sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Argumentim:** Specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi janë hartuar/pecjell pranë sektorit të prokurimeve me ane të kërkesës për prokurim Nr. 5746 prot. , datë 25.10.2024, nga Drejtoria e Burimeve Njerezore, bazuar në nenin 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Në specifikimet teknike që janë hedhur në dokumentet teknike të tenderit nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

**Shënim:** Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

## **VLERA LIMIT E KONTRATËS,**

Vlera e fondit limit të kontratës është perlllogaritur nga inxhinieri i Bashkisë Himarë me preventivin me numer protokollit nr.4884 prot, datë 09.09.2024, është hartuar bazuar në mesataren e studimit të tregut, në mbështetj dhe zbatim të pikës 1, shkronja b) të nenit 76, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar ku parashikohet se: *b) studimi i tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim.* Praktikë e cila është e dokumentuar me dokumentacion shkresor në dosjen e prokurimit.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**